REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURiYETi
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 172/26 Dt. 22.04.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01 nr. 111/26, i datës 05.03.2026, i cili ka të bëjë me lejimin e rregullimit të rrethojave dhe infrastrukturës së strehimores për trajtimin e qeneve endacak, kështu që, pika 2 e vendimit bazik, ndryshohet dhe plotësohet dhe do të jetë:

2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nr. 53850.

3. Pjesët tjera të Vendimit 01 nr. 111/26, të datës 05.03.2026, mbesin të pandryshuara.

4. Obligohet Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

Për:

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Sektorit të Prokurimit,
- Arkivës së Kryetarit.